

Raport i Transparencës 2025

Grant Thornton Albania

Informacion për vitin fiskal të mbyllur 31 dhjetor 2025

Përmbajtja

- [Hyrje](#)
- [Struktura ligjore](#)
- [Struktura Organizative](#)
- [Grant Thornton International \(GTIL\)](#)
- [Grant Thornton në Shqipëri, Kosovë, Mal i Zi & Maqedoni](#)
- [Prezenca jonë në Shqipëri](#)
- [Prezenca jonë në Mal te Zi](#)
- [Shërbimet tona](#)
- [Politikat e kontrollit të cilësisë](#)
- [Punonjësit dhe kultura](#)
- [Informacione Financiare](#)
- [Njësi ekonomike me interes publik \(PIE\)](#)
- [Auditimet e Entiteteve me Interes Publik – 2025](#)

Hyrje

Kam kënaqësinë t'ju paraqes raportin e transparencës të Grant Thornton Albania për vitin 2025.

Ne në Grant Thornton Albania mbështesim organizatat dinamike të rriten dhe të bëhen të suksesshme. Ne punojmë ngushtësisht me stafin drejtues të klientëve për të kuptuar më mirë vështirësitë që këto organizata kanë dhe më pas marrim një rol aktiv në gjetjen e zgjidhjeve më të përshtatshme.

Suksesi ynë i vazhdueshëm mbështetet në përvojën tonë të gjerë e cila, së bashku me stafin tonë, formon bazën e aftësisë për të ndihmuar çdo klient në mënyrën më të mirë të mundshme. Ne ndërthurim njohuritë tona me ekspertizën ndërkombëtare dhe kjo e bën Grant Thornton Albania ndryshe nga të tjerët.

Grant Thornton Albani është lider në këshillimin e biznesit, të dedikuar për t'i shërbyer kërkesave të klientëve në sektorin privat, shoqërive të listuara dhe shoqërive në sektorin publik, duke çliruar potencialet e tyre për rritje, përmes ofrimit të një game të gjerë shërbimesh të auditimit, taksave dhe këshillimit. Nëpërmjet rritjes së stafit në shërbim ndaj klientëve, mbështetjes së vazhdueshme të partnerëve tanë dhe krijimit të rrjeteve të shkurtra të vendimmarrjes, trajtojmë situata komplekse dhe shumë konfidenciale, duke dhënë mendimin tonë jo-konvencional dhe qasjen tonë në zgjidhjen e problemeve në mënyrë profesionale.

Për më shume se pesëmbëdhjetë vite, ne jemi pjesë e rrjetit ndërkombëtar, Grant Thornton, duke zhvilluar marrëdhëniet me shoqëritë më të mëdha në vend, duke ofruar shërbime drejt një numri të madh klientësh brënda dhe jashtë vendit, & bashkuar praktikat ndërkombëtare me njohuritë dhe eksperiencën tonë.

Grant Thornton është një nga shoqëritë lider në ofrimin e shërbimeve të konsulencës për çështjet që lidhen me taksat dhe auditimin. Me më shume së 80,000 punonjës, që ushtrojnë aktivitetin në 150 vende, ne jemi të fokusuar të bëjmë diferencën për klientët, kolegët dhe mjedisin që na rrethon.



Dr. Kledi Kodra, FCCA
Managing Partner



Struktura Organizative.

Struktura ligjore

Grant Thornton sh.p.k është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në Shqipëri në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 9901 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” datë 14.04.2008.

Kapitali i shoqërisë zotërohet nga Z. Kledian Kodra në masën 80% dhe nga Grant Thornton Consulting Doo e themeluar në Maqedoni, në masën 20%.

Ne jemi të përkushtuar për të krijuar një kulturë të fortë të përsosmërisë dhe etikës. Partnerët tanë vendosin përkushtimin e tyre në biznes dhe motivojnë stafin për të arritur standardet më të larta të sjelljes dhe performancës.

Shpërblimi i partnerëve


Partnerët paguhen në bazë të pagës së tyre vjetore. Përveç kësaj, partnerët mund të marrin bonuse performance dhe dividendë sipas pjesëmarrjes së tyre në shoqëri

Shoqëria administrohet nga Z. Kledian Kodra, ortak i shoqërisë si dhe auditues ligjor i regjistruar në Shqipëri.

Pjesë e shoqërisë janë tre auditues ligjorë të regjistruar pranë Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar në Republikën e Shqipërisë:

- **Z. Kledian Kodra, FCCA**
- **Znj. Erjona Isufi, AL**
- **Znj. Esmeralda Gjomemo, AL**

Struktura Organizative



A low-angle, upward-looking photograph of several modern skyscrapers with glass facades. The buildings are set against a clear blue sky. The perspective creates a sense of height and architectural grandeur. A large, semi-transparent purple shape is overlaid on the left side of the image, containing the text.

Grant Thornton International (GTIL).

Grant Thornton International (GTIL)

Pranimet e shoqërive anëtare

Grant Thornton Shpk është shoqëri anëtare e GTIL. GTIL është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar në Angli dhe Uells si një organizatë që nuk ofron drejtpërdrejt shërbime për klientët. Shërbimet ofrohen nga shoqëritë anëtare në mbarë botën, të cilat përdorin metodologji të përbashkëta që garantojnë eksperiencë dhe standarde të qëndrueshme për klientët e të gjitha shoqërive anëtare.

Shoqëritë - duhet të plotësojnë një numër kriteresh për tu konsideruar për anëtarësim, të cilat përfshijnë:


- reputacionin e shoqërisë së ardhshme për cilësinë dhe respektimin e standardeve të larta;
- miratimi i politikave, procedurave dhe metodologjive globale, të cilat përfshijnë metoda dhe sisteme kontrolli të cilësisë për ofrimin e shërbimeve për klientët, protokolleve të angazhimit dhe politika etike dhe të pavarësisë;
- mirëmbajtja e një sistemi të kontrollit të cilësisë që plotëson ose tejkalon marrëveshjen e Standardeve Ndërkombëtare të Kontrollit të Cilësisë (SNKC) për vlerësimin periodik të sistemit të kontrollit të cilësisë nga ekipet globale të monitorimit të cilësisë.

Informacion më të detajuar rreth GTIL mund të gjeni në adresën e mëposhtme:

<https://www.grantthornton.global/en/>


Grant Thornton Global

Shifrat Rajonale



8.61 Shkalla e kënaqësisë së klientëve

Bazuar në katër nxitësit tanë kyç të angazhimit. Sipas 11,300 përgjigjeve nga 34 firma anëtare, të përfshira në raportin global të benchmarking-ut ClientVoice.



Grant Thornton Albania.

Grant Thornton në Shqipëri, Kosovë, Mal i Zi & Maqedoni

Grant Thornton është një prej shoqërive të shërbimit profesional më të admiruara, e dedikuar në dhënien e shërbimeve për një numër të madh dhe të shumëllojshëm klientësh të cilët përfshinë korporatat, institucionet financiare, qeveritë dhe individët. Ne jemi të fokusuar në çlirimin e potencialit për rritje të klientëve, nëpërmjet ofrimit të një game të gjerë shërbimesh të auditimit, taksave dhe konsulencës.

Ne përfshijmë ekspertizë teknike vlerë-shtuese, e cila përmes intuitës, eksperiencës dhe besimit të fituar nga një përvojë e gjerë në sektorë të ndryshëm dhe njohjes së thellë të klientëve tanë, kontribuon në ofrimin e shërbimeve të përshtatshme dhe zgjidhjeve gjithëpërfshirëse, nëpërmjet kombinimit të fuqive nga të gjitha linjat tona të shërbimit, duke operuar si një shoqëri e integruar. Përmes skuadrës sonë të shërbimit të klientit, partnerëve dhe zinxhirit të shkurtuar të vendimmarrjes, ne sigurojmë një pikpamje më të gjerë dhe veprojmë në një mënyrë e cila është po aq e shpejtë dhe efikase sikurse janë dhe klientët tanë.

Për të paraqitur një pamje të vetme tek klientët, ne veprojmë si një strukturë e vetme e cila përbëhet nga kater shtete: Maqedonia, Kosova, Mali i Zi dhe Shqipëria. Avantazhi ynë më i fortë konkures është aftësia për t'i shërbyer në rajon organizatave dinamike, me zgjidhje të përshtatura sipas nevojave individuale. Gjithashtu me prezencën tonë lokale ne garantojmë përgjigje ndaj kërkesave dinamike të klientëve dhe tendencave të tregut, të inkurajuar në vazhdimësi nga bashkëpunimi reciprok mes anëtarëve.


Për të paraqitur një pamje të vetme tek klientët, ne veprojmë si një strukturë e vetme e cila përbëhet nga kater shtete: Maqedonia, Kosova, Mali i Zi dhe Shqipëria. Avantazhi ynë më i fortë konkures është aftësia për t'i shërbyer në rajon organizatave dinamike, me zgjidhje të përshtatura sipas nevojave individuale. Gjithashtu me prezencën tonë lokale ne garantojmë përgjigje ndaj kërkesave dinamike të klientëve dhe tendencave të tregut, të inkurajuar në vazhdimësi nga bashkëpunimi reciprok mes anëtarëve.



Prezenca jonë në Shqipëri

Fokusi i veprimitarisë sonë në Shqipëri

Grant Thornton e vendosi praninë e saj në Shqipëri në vitin 2009. Grant Thornton Albania është një nga ofruesit kryesorë të shërbimeve kombëtare të auditimit, këshillimit, tatimeve dhe shërbimeve ligjore. Zyra jonë në Tiranë ka zhvilluar marrëdhënie të gjera me kompanitë më të mëdha në vend, duke u shërbyer një baze të gjerë klientësh vendas dhe ndërkombëtarë, përmes kombinimit të metodologjive dhe sistemeve të nivelit botëror me njohuritë lokale dhe përvojën specifike sipas industrive. Gjatë viteve të fundit kemi përjetuar një zhvillim të fuqishëm dhe jemi krenarë për pozicionin tonë si një firmë lider e shërbimeve profesionale, me aspiratën për të qenë një partner i qëndrueshëm, i besueshëm, fleksibël dhe afatgjatë, i fokusuar te klientët me instinkt për rritje. Nëse dëshiron një version më të shkurtër për slide ose një formulim edhe më formal për raport vjetor, mund ta përshtas menjëherë.



+40

Professional Staff



6

Experienced Managers



ACCA

Platinum Employer



Trainee Development - Platinum



No.1

In Albania for
Audit Services in
2020



18

Years Track
Record

Prezenca jonë në Mal te Zi

Fokusi i veprimtarisë sonë në Mal te Zi

Grant Thornton e vendosi praninë e saj në Mal të Zi në vitin 2023. Grant Thornton Montenegro është një ofrues i shërbimeve kombëtare të auditimit, këshillimit, tatimeve dhe shërbimeve ligjore. Zyra jonë në Podgoricë ofron këshilla dhe ekspertizë profesionale për t'ju mbështetur në çdo hap të rrugëtimit tuaj. Që nga ndihma për të identifikuar vendndodhjen më të përshtatshme, deri te ngritja e një dege apo filiali, ne jemi të përkushtuar të ofrojmë këshilla praktike dhe në kohë, duke ju lejuar të përqendrohemi në arritjen e objektivave tuaja të biznesit dhe rritjes..



+1

Partner



+2

Professional Staff

Shërbimet tona



1. Audit

- Audit services
- Financial accounting
- Advisory services
- IFRS conversions
- Corporate reporting
- Risk assurance



2. Advisory

- Business consulting
- Business risk services
- Forensic services
- Recovery & reorganization
- Valuations
- M&A advisory
- Financial Due Diligence
- Transactional advisory services



3. Tax

- National and international tax services
- Direct and indirect tax
- Global mobility services
- Tax planning
- Tax policy and controversy
- Tax reporting and strategy
- Tax Due diligence
- Transfer pricing
- Double Tax Treaty relief



4. Legal

- CoCorporate, governance and compliance
- Employment legislation / employment related disputes
- Data protection/GDPR
- Contractual drafting
- Banking and financial sector legislation
- Legal representation
- Legal Due Diligence
- Licensing/permitting



5. Accounting & Outsourcing

- Payroll services
- HR consulting
- Bookkeeping
- Business process outsourcing
- Compilation of financial statements
- Staff leasing
- Employment agency functions

Drejtimit i Sigurt dhe Cilësor

Politikat e kontrollit të cilësisë

Qëllimi ynë është të vendosim sisteme rigorozë të cilësisë të dizenuar për të na dhënë siguri të arsyeshme që shoqëria dhe punonjësit e saj të jenë në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat rregullatore dhe ligjore dhe të ofrojnë shërbime me cilësi të lartë.

Pavarësia dhe cilësia e shërbimeve të ofruara nga shoqëria janë faktorë shumë të rëndësishëm për të ardhmen e aktivitetit. Prandaj, ne kemi hartuar dhe implementuar një sërë politikash dhe procedurash në lidhje me sistemet e menaxhimit të cilësisë dhe proceset e kontrollit të brendshëm, masat e vlerësimit të riskut dhe sistemet e monitorimit që sigurojnë që të gjithë ne jemi në përputhje me standardet e larta që kemi vendosur - standardet që klientët tanë presin.

Shoqëria ka procedura rigorozë të menaxhimit të cilësisë, të cilat përfshijnë:

- manualet teknike dhe proceduriale - për të siguruar që shërbimi të ofrohet në mënyrë të vazhdueshme me standard të lartë;
- trajnim dhe zhvillim të vazhdueshëm të të gjithë partnerëve dhe punonjësve;
- vlerësim vjetor të të gjithë stafit;
- Procedura proaktive të kontrollit të cilësisë për të siguruar që çdo detyrë përmbush standardet e kërkuara (Rishikimi i Kontrollit të Cilësisë së Angazhimit);
- rishikimi i proceseve të cilësisë së shërbimeve të sigurisë për të mundësuar që drejtimi të fitojë siguri se ekzistojnë procedurat e nevojshme, janë duke funksionuar dhe janë efektive (Rishikimi i Kontrollit të Brendshëm të Cilësisë - "SNKC1" - rishikimet e cilësisë nga GTIL).

Politikat e kontrollit të cilësisë

Shoqëria jonë adopton një kuadër të menaxhimit të riskut ku drejtimi është përgjegjës për cilësinë e shërbimeve të kryera dhe siguron zbatimin e procedurave të përshtatshme në baza vjetore. Përmes identifikimit të dobësive të mundshme, merren masa të përshtatshme për të monitoruar plotësisht proceset e kontrollit. Qasja jonë e menaxhimit të cilësisë për auditimin dhe detyrat e raportimit financiar ka disa elementë kyç:

- një qasje të qendrueshme dhe rigoroze të auditimit të bazuar në rrezik; me burime të rëndësishme të angazhuara për të siguruar cilësinë e auditimit.
- etika dhe integriteti; ne pranojmë/ vijojmë t'ju ofrojmë shërbime vetëm klientëve që demonstrojnë integritet. Kjo arrihet përmes vlerësimit të parametrave relativë që kanë të bëjnë me pranimin dhe vijimin e klientëve (Pranimi & Vijimi i Marrëdhënieve me Klientë & Politikat dhe Procedurat e Angazhimeve Specifike të Auditimit)
- aftësitë dhe cilësitë personale të partnerëve dhe punonjësve dhe përputhshmëria e tyre me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë të IFAC (Kërkesat Etike)
- kryerja e auditimeve në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat ligjore për raporte cilësore të auditimit
- zhvillimin e sistemeve efektive të monitorimit të detyrave (Politikat dhe Procedurat e burimeve njerzore)
- dokumentacion që ofron siguri të arsyeshme në lidhje me të gjitha elementet e sistemit të kontrollit të cilësisë brenda shoqërisë (Dokumentacioni)
- monitorimi i vazhdueshëm dhe sigurimi se politikat dhe procedurat e kontrollit të cilësisë janë gjithmonë relevante, të përditësuara, të mjaftueshme, efikase dhe në përputhje me praktikat aktuale. Procedurat duhet të përfshijnë gjithashtu vlerësimin e përhershëm të sistemeve të kontrollit të cilësisë së shoqërisë
- objektiviteti dhe pavarësia - kuptimi nga e gjithë shoqëria se reputacioni ynë i fituar me vështirësi varet nga cilësia e punës sonë dhe nga cilësia e vendimeve që ne marrim.

Burimet për ofrimin e auditimit cilësor

GTIL siguron burime që ndihmojnë shoqëritë anëtare në dhënien e një auditimi cilësor dhe rigoroz.

Ato përfshijnë:

- Metodologjia e auditimit Horizon, me mbështetjen e programeve kompjuterike, manualeve dhe politikave më të fundit, të krahasuara me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, Standardet Ndërkombëtare të Kontrollit të Cilësisë dhe Kodi i Etikës për Kontabilistët Profesionalë i IFAC
- Protokollet që u mundësojnë shoqërive anëtare të konsultohen me specialistë të auditimit në firmat e tjera anëtare në të gjithë organizatën ndërkombëtare
- Një shërbim gjithëpërfshirës intranet që përfshin informacion të përditësuar për shoqëritë anëtare mbi standardet përkatëse profesionale, një shërbim ndihme për Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, çështjet më të debatuar, formate të pasqyrave financiare dhe shembuj rastesh konkrete.

Përsa i përket auditimeve ligjore, Grant Thornton Albania përdor programin e auditimit, Voyager të GTIL, i cili është plotësisht në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit.

Në vitin 2017, GTIL publikoi rishikimin e metodologjisë globale të auditimit të ofruar përmes një programi të ri të zhvilluar në partneritet me Microsoft (LEAP). Për të nxitur adoptimin dhe angazhimin e këtij ndryshimi, do të ndërmerren një sërë programesh globale trajnimi për të gjitha shoqëritë anëtare.

Cilësia e Auditimit

Siç është e qartë në këtë raport, cilësia është shumë e rëndësishme për shoqërinë tonë, cilësia në punën tonë, cilësia në praktikat tona dhe cilësia e stafit tonë.

Të rëndësishme për suksesin tonë në arritjen dhe ruajtjen e cilësisë janë strukturat tona të cilat mbështesin objektivat tona ndërsa ne vazhdojmë të rritemi si shoqëri.

Grant Thornton International ofron burime për mirëmbajtjen e cilësisë së auditimit, duke përfshirë:

- një metodologji auditimi, e mbështetur nga një program kompjuterik i përditësuar i cili përdoret në shkallë globale;
- politika dhe procedura të përfshira në manualët e auditimit në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit, kontrollit të cilësisë, pavarësisë dhe etikës;
- protokolle të cilat i mundësojnë shoqërive anëtarë të konsultohen me ekipet e standardeve globale të auditimit dhe, nëse është e nevojshme, me specialistë të auditimit në shoqëri të tjera anëtare;
- protokolle të cilat i mundësojnë shoqërive anëtare që të konsultohen me qendrën e informacionit dhe asistencës të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF);
- një shërbim intranet gjithëpërfshirës i cili përfshin informacion të përditësuar për shoqëritë anëtare për auditimin, raportimin financiar, dhe standardet e etikës profesionale dhe pavarësisë si dhe udhëzime mbi zbatimin efektiv të tyre.

Rishikimi i Cilësisë së Auditimit në Grant Thornton

Çdo firmë anëtare është e detyruar t'i nënshtrohet një inspektimi të sistemit të kontrollit të cilësisë

Çdo firmë anëtare është e detyruar t'i nënshtrohet një inspektimi të sistemit të kontrollit të cilësisë, të referuar si Rishikimi i Cilësisë së Auditimit në Grant Thornton, të paktën një herë në tre vjet. Procesi i Rishikimit të Cilësisë së Auditimit në Grant Thornton është hartuar për të monitoruar pajtueshmërinë e firmës anëtare me standardet profesionale dhe politikat dhe procedurat globale të auditimit.

Rishikimi i Cilësisë së Auditimit në Grant Thornton kryhet nga partnerë të pavarur dhe të kualifikuar në mënyrë të përshtatshme dhe menaxherë nga firma të tjera anëtare nën drejtimin e përgjithshëm të Drejtuesit Global të Kontrollit të Cilësisë së Auditimit.

Ekipe të inspektimit të Rishikimit të Cilësisë së Auditimit në Grant Thornton rishikojnë punën e auditimit të kryer nga secila firmë anëtare. Procesi i inspektimit përfshin një vlerësim të politikave dhe procedurave të firmës anëtare të zbatueshme për praktikën e saj të shërbimeve të sigurisë, krahasimin e politikave dhe procedurave kundrejt politikave dhe procedurave përkatëse të organizatës ndërkombëtare. Ekipi i inspektimit shqyrton pasqyrat financiare, raportet e auditimit, letrat e punës dhe dosjet e angazhimit. Ekipi i inspektimit gjithashtu interviston partnerët dhe njerëzit për çështje të ndryshme.

Anëtarët e ekipit të inspektimit të Rishikimit të Cilësisë së Auditimit në Grant Thornton vlerësojnë nëse sistemi i kontrollit të cilësisë i një firme është dizajnuar, zbatuar dhe operuar për t'i siguruar firmës anëtare një siguri të arsyeshme që firma anëtare dhe personeli i saj janë në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat ligjore dhe rregullative të zbatueshme; dhe raportet e lëshuara nga firma anëtare janë të përshtatshme në rrethanat e caktuara.

Këto përfshijnë përgjegjësitë e udhëheqjes për cilësinë, etikën dhe pavarësinë, pranimin dhe vazhdimësinë e klientëve, burimet njerëzore, ecurinë e angazhimit dhe monitorimin.

Ekipi i inspektimit, si pjesë e vlerësimit të performancës së angazhimit, gjithashtu shqyrton një përzgjedhje të angazhimeve të sigurisë. Në përfundim të çdo Rishikimi të Cilësisë së Auditimit në Grant Thornton, organizata globale lëshon një raport bazuar në gjetjet e inspektimit. Raporti mbi sistemin e kontrollit të cilësisë të një firme shprehet nëse sistemet e kontrollit të cilësisë:

- janë hartuar në mënyrë të përshtatshme dhe duke vepruar në mënyrë efektive (një raport pa rezervë)
- janë hartuar në mënyrë të përshtatshme dhe duke vepruar në mënyrë efektive përveç një ose më shumë mangësive të rëndësishme (një raport me rezervë)
- kanë dobësi materiale në hartimin ose funksionimin e tyre (një raport kundër).

Ekzistojnë procese ekuivalente për shërbimet e tjera të rrjetit.

Cilësia e Ofrimit të Shërbimeve në Taksa

Shërbimet ne fushën e tatim-taksave konsiderohen si një çështje e rëndësishme për shumicën e shoqërive dhe janë ndër faktorët kryesor të rritjes profesionale për Grant Thornton.

Mjedisi për planifikimin e taksave po bëhet gjithnjë e më tepër politik dhe i një profili të lartë.

Grant Thornton pranon se ndryshimi i këtij mjedisi nënkupton se klientët tanë kanë nevojë për konsulentë të besueshëm të cilët mund të shpjegojnë dhe sqarojnë legjislacionin tatimor shpesh të ndërlikuar.

Ne jemi përqendruar në përforcimin e procesit tonë të rishikimit dhe programeve tona të trajnimit, me qëllim rritjen dhe përmirësimin e aftësive dhe ekspertizës së punonjësve tanë në ofrimin e shërbimeve më profesionale.

Për tu siguruar që klientët tanë të vazhdojnë të marrin një shërbim të qëndrueshëm e me cilësi të lartë, shoqëritë anëtare të GTIL kanë punuar ngushtë së bashku për të rritur bashkëpunimin ndërkufitar dhe investimin global në teknologji.

Taksat në praktikë

Ne në Grant Thornton kombinojmë njohuritë më të thella teknike me aftësitë për të ofruar shërbime cilësore dhe profesionale ndërkohë që menaxhimi i riskut është thelbësor për ruajtjen e biznesit tonë.

Të gjitha shoqëritë anëtare duhet të demonstrojnë përkushtimin e tyre për të vazhduar zhvillimin profesional të vazhdueshëm të punonjësve dhe specialistëve të taksave, për t'u mundësuar atyre që të shfrytëzojnë mundësitë për t'u bërë ofruesit kryesorë të shërbimeve në tregjet e tyre.

Cilësia e Shërbimeve të Konsulencës

Shërbimet tona të konsulencës ndihmojnë klientët të krijojnë, transformojnë dhe mbrojnë vlerat e tyre. Gjithashtu ne ndihmojmë klientët tanë të financojnë rritjen dhe optimizojnë operacionet e tyre, ne i këshillojmë ata se si të menaxhojnë riskun dhe mjedisin rregullator.

Shërbimet e konsulencës dallojnë nga shërbimet e auditimit të ofruara nga Grant Thornton pasi këto shërbime përgjithësisht nuk janë të rregulluara apo ofruara sipas formateve të përcaktuara nga rregulloret apo legjislacioni. Proceset e cilësisë së GTIL-it janë të hartuara për të lejuar shoqëritë anëtare të jenë fleksibel në përmbushjen e kërkesave të tregut lokal dhe për të siguruar që, kudo që të jetë e mundur, praktikat e përbashkëta të punës të aplikohen ndërkombëtarisht.

Me zgjerimin e listës sonë të klientëve ndërkombëtarë është rritur nevoja për të siguruar që përvoja e klientit të mos ndryshojë nga një vend në tjetrin. Kjo kërkon standardizim më të gjerë të praktikave të punës si dhe trajnime rreth bashkëpunimit midis shoqërive anëtare të GTIL.

Cilësia është thelbësore për vlerën që ne u sjellim klientëve tanë dhe nuk ka një zgjidhje të vetme apo kontroll që do të sigurojë që standardet e cilësisë janë zbatuar.

Ne kemi një qasje të shumëfishtë ndaj kontrollit të cilësisë që përfshin:

- Menaxhimi i riskut;
- Vendosjen e metodologjive standarde për linjat e shërbimit;
- ofrimin e linjave të shërbimit dhe grupeve mbështetëse të industrisë dhe të drejtimit
- Një program i akademive rajonale të trajnimit;
- Një program rishikimi të shoqërisë anëtare të GTIL;
- Përmirësimi i ndërlidhjes mes shoqërive.

Një pjesë thelbësore e qasjes së Grant Thornton International Ltd është të sigurojnë që shoqëritë anëtare dhe stafi i tyre që ndërmarrin punën e klientit janë të lidhur mirë me pjesët e tjera të rrjetit që janë më të afta t'i mbështesin. Në vitin 2016, Grant Thornton International Ltd publikoi PyetëSORIN për Rreziqet Tatimore dhe të Konsulencës (PRTK), i cili u lejon shoqërive anëtare që të krahasojnë rreziqet dhe proceset e tyre të cilësisë ndaj standardeve të GTIL.

Punonjësit dhe Kultura

Punonjësit dhe kultura

Si një shoqëri shërbimesh profesionale që ofron një gamë të plotë të shërbimeve të auditimit, taksave dhe konsulencës për klientët tanë, është e domosdoshme që cilësia të jetë në themelin e gjithçkaje që bëjmë. Kritike për suksesin tonë në arritjen dhe ruajtjen e standardeve tona të cilësisë, janë edhe nismat tona kulturore rreth rekrutimit, zhvillimit, trajnimit dhe menaxhimit të burimeve njerëzore në mbështetje të këtij objekti.



Ekipi ynë angazhohet në një strukturë që promovon:



Përdorimin e praktikave më të mira ndihmëse për të tërhequr kandidatët më të mirë dhe bën përvojën e punësimit një faktor promovues të Grant Thornton si një nga vendet më të mira për të punuar;

Zhvillimin dhe mbajtjen e punonjësve tanë nëpërmjet programeve që i nxisin dhe sfidojnë ata të jenë udhëheqës më të mirë në fushën e tyre të zgjedhur të ekspertizës;

Rëndësinë e kulturës dhe vlerave të shoqërisë që mbështesin punonjësit, nga fillimi i punësimit, përgjatë gjithë karrierës;

Një kulturë të trajnimit të vazhdueshëm dhe zhvillimit profesional përmes procesit të menaxhimit të performancës që gjithashtu njih dhe shpërblen këtë kontribut; dhe fokusin në arritjen e ekspertizës teknike dhe përsosmërisë.

Punësimi i personelit të duhur për biznesin tonë është kritik dhe për të mbështetur këtë, ne kemi një ekip të përkushtuar, qëllimi kryesor i të cilit është gjetja e personit më të vlefshëm për rolet brenda shoqërisë. Ky proces mbështetet nga politika jonë e rekrutimit dhe përzgjedhjes që zbatohet në të gjithë biznesin.

Në ditën e tyre të parë të punës, çdo anëtar i ri i stafit merr pjesë në një trajnim formal që mbulon një sërë temash që i mundësojnë punonjësit të kuptojë kulturën e Grant Thornton.

Trajnimi dhe zhvillimi profesional i punonjësve tanë është i rëndësishëm për suksesin e biznesit tonë dhe aftësinë tonë për të siguruar që cilësia është e lartë në të gjitha fushtat tona të shërbimit. Filozofia jonë e zhvillimit bazohet jo vetëm në trajnime formale, me mësim në vendin e punës por edhe në nivele të rëndësishme të edukimit të vazhdueshëm profesional.

Struktura jonë siguron një rrugë të qartë për përparimin individual në karrierë dhe programet tona të mësimit dhe zhvillimit sigurojnë që të gjithë punonjësit tanë të kenë qasje në trajnim, i cili ndihmon përparimin dhe avancimin e karrierës së tyre.

Për të mbështetur më tej kulturën tonë të zhvillimit të vazhdueshëm ne kryjmë rishikime të performancës në baza vjetore.

Informazione Finanziaria

Informacione Financiare

Ndarja e të ardhurave të Grant Thornton sh.p.k për vitin 2025 është si në vijim:

Shërbimi	për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025 (të ardhurat në mijë lekë)
Auditime	53,223
Këshillim në taksa	27,562
Të tjera	69,763
Totali	150,515

Njësi ekonomike me interes publik (PIE)

Lista e njësive ekonomike me interes publik për të cilat Grant Thornton Shpk ka lëshuar një opinion të auditimit të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025 është dhënë në vijim.

Përkufizimi i një njësie ekonomike me interes publik për këtë qëllim është ai i dhënë sipas ligjit Nr. 10 091 datë 5.03.2009 ndryshuar me ligjin nr.10297 date 08.07.2010 Për një ndryshim në ligjin nr. 10 091, datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar" dhe me ligjin 47/2016 "Per disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 091, datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar", te ndryshuar.

"Njësi ekonomike me interes publik" janë:

- të gjitha njësitë ekonomike të listuara në bursë;
- bankat dhe degët e bankave të huaja, si dhe subjektet e tjera financiare jobanka, të licencuara nga Banka e Shqipërisë;
- shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit, shoqëritë administruese të fondeve të investimeve kolektive, shoqëritë administruese të fondeve të pensionit vullnetar;
- shoqëritë e tjera shtetërore ose private, të cilat janë të rëndësishme për interesin e publikut, për shkak të natyrës së biznesit, madhësisë ose numrit të punëmarrësve të tyre, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Ky ligj është përafshuar pjesërisht me:

Direktivën 2006/43/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 17 maj 2006, "Mbi auditimet ligjore të llogarive vjetore dhe llogarive të konsoliduara, amendimin e direktivave të Këshillit 78/660/KEE dhe 83/349/KEE dhe shfuqizimin e direktivës së Këshillit 84/253/KEE", e amenduar, Celex: 32006L0043; Fletorja Zyrtare e BE-së, L 157, datë 9.6.2006, faqe 87-107;

Rregulloren (BE) Nr.537/2014 të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 16 prill 2014, "Mbi kërkesat specifike në lidhje me auditimin e njësive me interes publik dhe shfuqizimin e vendimit të Komisionit 2005/909/KE", Celex: 32014R0537, Fletorja Zyrtare e BE-së, L 158, datë 27.5.2014, faqe 77-112.

Auditimet e Entiteteve me Interes Publik – 2025

Gjatë vitit 2025, Grant Thornton Shpk kreu auditimin për entitete me interes publik si vijon:



SHOQERIA	AKTIVITETI
ABI BROKER SIGURIMESH SHA	INSTITUCIONE JOBANKA, TË LICENSUARA NGA BANKA E SHQIPËRISË
ABI EIA	INSTITUCIONE JOBANKA, TË LICENSUARA NGA BANKA E SHQIPËRISË
ABI FLEX EURO	INSTITUCIONE JOBANKA, TË LICENSUARA NGA BANKA E SHQIPËRISË
ABI FLEX USD	INSTITUCIONE JOBANKA, TË LICENSUARA NGA BANKA E SHQIPËRISË
ABI INVEST SH.A.	INSTITUCIONE JOBANKA, TË LICENSUARA NGA BANKA E SHQIPËRISË
AGJENSIA E SIGURIMIT TE DEPOZITAVE	INSTITUCIONE JOBANKA, TË LICENSUARA NGA BANKA E SHQIPËRISË
AMBRA SHPK	SHOQËRI SHËRBIMI
ANTEA CEMENT SHA	SHOQËRI PRODHIMI
BALFIN - BALKAN FINANCE INVESTMENT GROUP SHPK	SHOQËRI SHËRBIMI
BALFIN CONSTRUCTION SHPK	SHOQËRI NDERTIMI
BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA	BANKAT DHE DEGËT E BANKAVE TË HUAJA
BANKA E PARË E INVESTIMEVE-ALBANIA/ FIRST INVESTMENT BANK- ALBANIA SHA	BANKAT DHE DEGËT E BANKAVE TË HUAJA
BANKA E TIRANES SHA	BANKAT DHE DEGËT E BANKAVE TË HUAJA
BANKA E TIRANES SHA	BANKAT DHE DEGËT E BANKAVE TË HUAJA
CRIMSON FINANCE FUND ALBANIA SHA	INSTITUCIONE JOBANKA, TË LICENSUARA NGA BANKA E SHQIPËRISË
CRIMSON FINANCE FUND ALBANIA SHA	INSTITUCIONE JOBANKA, TË LICENSUARA NGA BANKA E SHQIPËRISË

SHOQERIA	AKTIVITETI
CWI-ALBANIA (ÇOKYASAR WIRE INDUSTRY ALBANIA) SHA	SHOQËRI PRODHIMI
CWI-ALBANIA (ÇOKYASAR WIRE INDUSTRY ALBANIA) SHA	SHOQËRI PRODHIMI
ECFA SHPK	INSTITUCIONE JOBANKA, TË LICENSUARA NGA BANKA E SHQIPËRISË
ECFA SHPK	INSTITUCIONE JOBANKA, TË LICENSUARA NGA BANKA E SHQIPËRISË
EUROSIG SHA	SHOQËRI FINANCIARE TË LICENSUARA NGA AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
FED INVEST	INSTITUCIONE JOBANKA, TË LICENSUARA NGA BANKA E SHQIPËRISË
GREEN COAST SHPK	SHOQËRI NDERTIMI
INSIG JETE SH.A	SHOQËRI FINANCIARE TË LICENSUARA NGA AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
INSIG SHA	SHOQËRI FINANCIARE TË LICENSUARA NGA AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
INTERSIG SHA	SHOQËRI FINANCIARE TË LICENSUARA NGA AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
INTERSIG SHA	SHOQËRI FINANCIARE TË LICENSUARA NGA AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
KARAVASTA SOLAR SHPK	SHOQËRI PRODHIMI
KID ZONE SHPK	SHOQËRI TREGTIMI
LENGARICA & ENERGY SHPK	SHOQËRI PRODHIMI
MATI HYDROPOWER SHPK	SHOQËRI PRODHIMI
MEGATEK SHA	SHOQËRI TREGTIMI

SHOQERIA	AKTIVITETI
NELT SHPK	SHOQËRI TREGTIMI
NEPTUN SHPK	SHOQËRI TREGTIMI
NEPTUN SHPK	SHOQËRI TREGTIMI
NOA SHA	INSTITUCIONE JOBANKA, TË LICENSUARA NGA BANKA E SHQIPËRISË
PHILIP MORRIS ALBANIA SH.P.K.	SHOQËRI TREGTIMI
PROCREDIT BANK SH.A	BANKAT DHE DEGËT E BANKAVE TË HUAJA
REGJISTRI SHQIPTAR I TITUJVE ALREG SHA	SHOQËRI TË LICENSUARA NGA AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
SHOQERIA KONCENSIONARE MARINA VLORE SHPK	SHOQËRI SHËRBIMI
SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP SHA	SHOQËRI FINANCIARE TË LICENSUARA NGA AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
SPAR ALBANIA SHPK	SHOQËRI TREGTIMI
TETE ALBANIA TUNNEL & MINNING SH.A	SHOQËRI PRODHIMI
TRANZIT SH.P.K	INSTITUCIONE JOBANKA, TË LICENSUARA NGA BANKA E SHQIPËRISË
UNION FINANCIAR TIRANE SHA	INSTITUCIONE JOBANKA, TË LICENSUARA NGA BANKA E SHQIPËRISË
VIENNA SIGURIM JETE SHA	SHOQËRI TË LICENSUARA NGA AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
VIG SERVICES SHQIPERI	SHOQËRI SHËRBIMI
VIRTUS LENDING SHA	INSTITUCIONE JOBANKA, TË LICENSUARA NGA BANKA E SHQIPËRISË
VOLTALIA ALBANIE SHPK	SHOQËRI PRODHIMI



© 2026 Grant Thornton sh.p.k . All rights reserved.

'Grant Thornton' refers to the brand under which the Grant Thornton member firms provide assurance, tax and advisory services to their clients and/or refers to one or more member firms, as the context requires. Grant Thornton International Ltd (GTIL) and the member firms are not a worldwide partnership. GTIL and each member firm is a separate legal entity. Services are delivered by the member firms. GTIL does not provide services to clients. GTIL and its member firms are not agents of, and do not obligate, one another and are not liable for one another's acts or omissions.

Grant Thornton Sh.p.k
Rr. "Sami Frasheri",
Kompleksi T.I.D, Shk. F, Floor 1
1001 Tirana
Albania

T +355 44 525 880

E contact@al.gt.com

grantthornton.al